

RELACION

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit, në mënyrë të veçantë nga produktet e duhanit dhe shtimin e masave për sigurimin e mbrojtjes së shëndetit të popullatës nga produktet e duhanit.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Duhani është e provuar tashmë që dëmton shëndetin e gjysmës së njerzve që konsumojnë atë aktivisht dhe ndikon negativisht në 30 % të njerzve që ndikohen drejtpërdrejt pasivisht nga produktet e duhanit. Ndikimin më të madh negativ duhani e ka në sëmundjet kardiovaskulare dhe në ato tumorale.

Heqja e markës në paketimin e cigareve synon të shkurajojë duhanpirjen duke hequr asocimin pozitiv të markës në konsumin e duhanin. Për këtë ka filluar të zbatohet edhe paketimi i thjeshtë (plain packaging) i cili quhet ndryshe edhe paketim standart, neutral, gjenerik apo homogjen.

Për herë të parë është zbatuar në Australi në vitin 2012. Më tej është shtrirë edhe në vende të tjera përfshirë Kanada, Belgjikë, Francë, Hungari (fillimi i zbatimit është shtyrë për në 2022), Irlandë, Mbretërinë e Bashkuar, Norvegji etj. Në Turqi do të fillojë të zbatohet në shtator 2019. Në Hollandë dhe në Slloveni do të fillojë të zbatohet në vitin 2020.

Në 31 maj 2016, në ditën botërore të luftës kundër duhanit, Organizata Botërore e Shëndetësisë i ka bërë thirrje qeverive të vendeve anëtare të bëhen gati për paketimin e thejstë.

Edhe ndryshimet e propozuara përcaktojnë që Shqipëria të fillojë të zbatojë paketimin e thjeshtë. Parashikohet të fillojë të zbatohet nga 1 janar 2022 për t'i lënë kohë industrisë prodhuese të bëjë përgatitjet e nevojshme.

Detajet e paketimit të thjeshtë të hartohen brenda 3 muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe të miratohen brenda 4 muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit nga Komiteti Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit.

Ndërkohë, që në 31 maj 2016 Komiteti Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit ka marrë një vendim (Nr. 3) për të filluar zbatimin e vendosjes së fotografive të efekteve negative në trupin e njeriut nga përdorimi i duhanit apo "pictorials" siç quhen në terminologji ndërkombtarisht. Sipas vendimit në fjalë, "pictorials" duhet të kishin filluar të zbatoheshin në 1 janar 2018. Ende nuk ka vendime të KNMShPD për të dëshmuar se kush do të jetë fati i zbatimit të "pictorials" edhe në Shqipëri.

Konventa Kornizë e OBSH-së e vitit 2003 për Kontrollin e Duhanit (*Framework Convention on Tobacco Control*) në Artikullin 11 ka krijuar mundësinë e përdorimit edhe të figurave në pjesën paralajmëruese të pasojave të dëmshme në shëndet të produktëve të duhanit si pjesë e paketimeve të tregëtimit me pakicë të produkteve të duhanit.

“Pictorials” në paketimin e duhanit është përdorur në Kanada për herë të parë në vitin 2001. Në Europë përdoren në Mbretërinë e Bashkuar, Rumani, Itali, Greqi, etj.

Për rrjedhojë, propozohet detyrimi ligjor i fillimit të zbatimit të “pictorials” në Shqipëri.

Në të njëjtën procedurë si për paketimin e thjeshtë, edhe për “pictorials”, propozohet që ministria përgjegjëse të përgatisë formatet e paralajmërimeve tekst dhe figurë brenda 3 muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit, ndërsa KNMShPD t’i miratojë brenda 4 muajsh dhe fillimi i zbatimit të jetë data 1 janar 2022.

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projektligj nuk synon përafrim me legjislacionin e BE-së, megjithëse në mbështetje të propozimit sjell në vëmendje që Direktiva 2014/40/EU e Parlamentit Europian ka krijuar bazën e një albumi me figura paralajmëruese për pasojat e dëmshme në shëndet për t’u përdorur në paketimin e produkteve të duhanit që tregtohen me pakicë nga vendet anëtare.

V. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji hartohet në mbështetje në neneve 81 pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën.

VI. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRMBUSHJES SË OBJEKTIVAVE TË AXHENDËS SË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË KOMBEVE TË BASHKUARA

Projektligji ndikon në përmbushjen e objektivit 3 “Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mërçqenies për të gjithë në të gjitha moshat” të axhendës së zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, konkretisht të angazhimit 3.4 i cili synon që deri në 2030 rënin e vdekshmërisë së parakohshme që i atribuohet sëmundjeve kardiovaskulare, kancerit, diabetit ose sëmundjes kronike të frymëmarrjes.

VI. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk parashikon efekte financiare në buxhetin e shtetit.

DEPUTETI PROPOZUES

Ilir BEQAJ